



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1306_02_15**;
- Ankesa e konsumatorit e datës **09.09.2015**;

në seancën e mbajtur më datë 28 janar 2015, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A.O. me shifër DPR - 15895 ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **Mbetet në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1306_02_15** i datës 23.02.2015.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 09.09.2015 ka pranuar ankesën e konsumatorit Abaz Osmanit me te cilën ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, i cili ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së që të shqyrtoi ankesën e lidhur me faturën e energjisë elektrike të muajit janar 2014 të ngarkuar nga KEDS-i. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se organi për shqyrtimin e ankesave nuk është bazuar në faktet e ankuesit dhe ka vendosur në mënyrë të njëanshme. Konsumatori në vazhdim të ankesës ka theksuar se ZRRE me asnjë provë nuk ka mundur të mohojë pretendimet e tij pasi nuk ka bërë matje të shpenzimit të rrymës nga ndonjë institucion i pavarur por i ka besuar matjeve të KEDS-it. Gjithashtu në ankesën e tij konsumatori ka theksuar se sa i përket falsifikimit të procesverbalit jep konstatime paushalle.

Me datë 06.01.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 2214330 me gjendje TL=15197 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=35562 kWh (tarifa e ulët), si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 35016752 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh

Pas kësaj Departamenti i Faturimit në KEDS me datë me datë 04.02.2014 i ka dërguar konsumatorit dy fatura mujore të energjisë elektrike për periudhën janar 2014, njëren me **390 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **19.95€**, kurse tjetrën me **718 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **52.44€**. Pas arritjes së këtyre faturave të energjisë elektrike konsumatori me datë 09.03.2014 ka parashtruar ankesë në KEDS duke kundërshtuar faturimin për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë



Me datë 28.03.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 35016752 ku TL=001623 kWh dhe TU=000456 kWh

Pas ankesës së konsumatorit, Departamenti për Konsumator në KEDS me datë 04.04.2014 i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike si dhe procesverbalin e inspektimit nr. 1185945 të datës 28.03.2014.

I pakënaqur me përgjigjen e KEDS-it, konsumatori ka parashtruar ankesë në DMK të ZRRE-së ku në ankesën e tij ka theksuar se përveç kontestimit të faturës së energjisë elektrike ai konteston edhe ndërrimin e njehsorit elektrik pasi është bërë pa prezencën e tij dhe se nënshkrimi i vendosur në procesverbal nuk është i tij.

Departamenti për Mbrojtjen e konsumatorëve në ZRRE me datë 23.02.2015 ka shqyrtuar ankesën e konsumatorit ka nxjerrë vendim duke e refuzuar ankesën e konsumatorit si të pabazuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, përkatësisht bazën e kundërshtimit të tij në ankesë dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e konsumatorit nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se vendimi i DMK-së nuk është i mbështetur në prova dhe në ligj.

Kundërshtimi i ankuesit se organi shqyrtues (DMK) nuk ka marrë për bazë një provë nuk qëndron, pasi që Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë procesverbalit të ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 010198 të datës 06.01.2014 dhe procesverbalit të inspektimit nr.1185945 të datës 28.03.2014 ka vërejtur se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike të njehsorit të vjetër elektirk nr. 2214330 me rastin e ndërrimit të njehsorit elektirk përputhet me gjendjen e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike, e gjithashtu edhe gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike e njehsorit elektrik nr. 35016752 e evidentuar në procesverbalin e inspektimit përputhet me gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike të evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe kundërshtimin tjetër të ankuesit se organi shqyrtues – DMK nuk ka mohuar pretendimet e tij lidhur me matjen e shpenzimit të energjisë elektrike nga ndonjë institucion i pavarur. Sa i përket kësaj pike Bordi i ZRRE-së thekson se përgjegjësi e shqyrtimit të saktësisë së pikës matëse është e laboratorit të Qendrës së Kalibrimit, e cila qendër bënë shqyrtimin e saktësisë së njehsorit elektrik. Megjithatë Bordi i ZRRE-së thekson se në vendimin e DMK është evidentuar edhe shpenzimi i energjisë elektrike të dy njehsorëve elektrik, të cilët kanë qenë në funksion te konsumatori dhe është konstatuar se nuk ka dallim në shpenzimin e energjisë elektrike të njehsorit elektrik të kontestuar nr.35016752 krahasuar me njehsorin e vjetër elektrik nr. 2214330, madje me njehsorin e ri elektrik nr. 35016752 ka rënir të shpenzimit të energjisë ekektrike në krahasim me njehsorin e vjetër. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se dallim në shpenzimin e energjisë mes njehsorit elektrik të vjetër dhe të ri është vetëm te koha tarifore, e që kjo ndikon në rritjen e vlerës financiare të kilovatorëve (kWh) të faturuar. Bordi i ZRRE-së konstaton se regjistrimi i energjisë elektrike i njehsorit elektrik nr. 35016752 është në pëputhje me strukturën tarifore me pakicë të energjisë elektrike të aprovuar nga ZRRE për konsumatorët e rregulluar tarifa e lartë aplikohet prej orës 07:00h deri në ora 22:00h gjatë sezonit të lartë dhe prej orës 08:00 deri në ora 23:00 gjatë sezonit të ulët. Po ashtu njehsori i ri digjital ka të integruar numëruesin tarifor i cili bënë rregullimin e kohës tarifore të shfrytëzimit të energjisë elektrike bazuar në strukturën tarifore me pakicë të energjisë elektrike të aprovuar nga ZRRE.

Pika tjetër e kundërshtimit të konsumatorit lidhur me falsifikimin e procesverbalit nga ana e KEDS-it rreth zëvendësimit të njehsorit elektrik. Bordi i ZRRE-së pas analizimit dhe vlerësimit edhe të kësaj pike ka konstatuar se pronësia e njehsorëve elektrike është e rregulluar me Ligjin për energjinë



elektrike, neni 32 paragrafi 1, ku thuhet se *“Pajisjet matëse për matjen e energjisë elektrike janë pronë e Operatorit të Sistemit të Transmisionit ose Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, siç përcaktohet në Ligjin për Energjinë”*, ndërsa nënshkrimi i vendosur në procesverbalin e përpiluar nga ekipi i KEDS-it nuk mund të verifikohet nga ZRRE.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 28.01.2016 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1338_06_15, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Enver Halimi, kryesues

Krenar Bujupi, anëtar

Arsim Janova, anëtar

Qemajl Mustafa, anëtar

Besim Sejfiqaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit A.O,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.